

NJOFTIM

Bazuar në ligjin **nr. 22/2018 “Për strehimin social”** i ndryshuar, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Bashkia Vau Dejës fton të gjithë qytetarët e interesuar, që të aplikojnë për të përfituar nga programi i strehimit social ***“Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme”***.

Për aplikimet banorët duhet të paraqiten pranë zyrës së strehimit social në Njësinë Administrative Bushat, për të regjistruar aplikimin duke u asistuar nga punonjësit e strehimit social në aplikim për të shmangur kështu çdo të metë në regjistrimin e kërkesës për strehim .

1. Kushtet për të përfituar nga programet e strehimit që do të zbatohen në Bashkinë Vau Dejës “Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme” janë:

- Të jetë banor i Bashkisë Vau Dejës;
- Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
- Të ketë një banesë në pronësi.

- Shtetas të huaj me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”, “refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese”.
- Individët/familjet që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë të ardhura sipas përcaktimeve të nenit 3 të Ligjit nr 22/2018 i ndryshuar.

2.Objektet dhe banesat , që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve dhe zonave të papërshtatshme, janë :

- Objektet/ banesat në rrezik shembjeje;
- Objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme .

3.Përparësi në trajtimin me këtë program sipas ligjit kanë:

- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale;
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktimat të trafikimit /viktimat të mundshme të trafikimit;

4.Dokumentat e nevojshme per aplikim në programin që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve të banesës egzistuese dhe zonave të papërshtatshme, janë:

1. Aplikanti duhet të paraqitet me kopje të mjetit të identifikimit.
2. Deklaratën e vërtetësisë së informacionit paraprak të pasqyruar në formularin e strehimit, me anë të së cilës aplikuesit i bëhen të njohura edhe përgjegjësitë ligjore që ai ka në lidhje me dhënien e një informacioni dhe fakteve të rreme.
3. Çertifikatën familjare.
4. Katër(4) fotografi të banesës ekzistuese.

Kjo faze e aplikimit është hapur nga data 1 Nëntor 2023 deri në datën 24 Nëntor 2023 nga ora 08.00 -16.00 në Njësinë Administrative Bushat.

Shënim (Të gjithë banoret të cilet kanë regjistruar kerkesat e tyre për këtë program më përpara, lutemi që të paraqiten brenda këtij afati për riaplikim dhe shprehje interesi për të vazhduar trajtimin nga ky program.)